

DISKUTIM

Marrëveshjet e tregtisë së lirë – Kosto dhe përfitime.

Prof. Dr. Sherif BUNDO, Shef i seksionit Bankë
Prof. Dr. Beshir CICERI, Shef i Seksionit Financë

Pranë Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit të Tiranës

Konferenca e sotme e organizuar nga Banka e Shqipërisë dhe Fakulteti i Ekonomisë i Universitetit të Tiranës, është një ngjarje e rëndësishme me përmasa sa shkencore aq edhe perspektive e dobiprurëse. Fillimisht na lejoni të falenderojmë institucionet organizatore dhe drejtuesit e tyre për faktin se tashmë po shndërrohet në një traditë jo vetëm organizimi i përvitshëm i konferencave të tilla, por po shndërrohen në traditë edhe konferencat me bashkëorganizatorë.

Të diskutosh për të njëjtin objekt mbas një referati me kohë të plotë dhe të prezantuar mirë, sikurse që rasti me referatin që sapo mbylli kohën e vet, është pak e vështirë. Është e vështirë edhe për auditorin ekzigjent, është e vështirë edhe për diskutantët. Por, mendojmë se pikërisht këtu qëndron edhe interesi dhe kurrësja.

Marrëveshjet e quajtura “të tregtisë së lirë” janë bërë tema të ditës për pothuaj gjithë opinionin ekonomik, politik, gazetaresk dhe administrativ në vendin tonë. Këta terma diskutohen gjerë edhe në vende të tjera të Ballkanit. Në aspektin morfologjik ne i kemi quajtur “Marrëveshje të Tregtisë së Lirë”, ndërsa në fakt ato janë “marrëveshje të tregtisë pa tarifa doganore” ose me tarifa doganore që reduktohen. Ato nuk janë dhe nuk mund të jenë kurrësesi, në kuptimin e plotë të fjalës “tregti e lirë”. Tregti e lirë në kuptimin e plotë të konceptit të përdorur nga Adam Smith-i nuk mund të ushtrohet në kushtet e sotme midis dy shtetesh, në mënyrë të veçantë në Ballkan, kur përveç pengesave dhe tagrave të shumta doganore, ***ekzistojnë edhe mjaft pengesa e procedura administrative, ligjore, kufitare, kufizime të lëvizjes së njerëzve*** etj.. Qytetarët e Rajonit nuk kanë mundur akoma të lëvizin lirisht midis vendeve të tyre e, jo më pastaj të ushtrojnë aktivitete ekonomike të

pakufizuara apo tregti të lirë. Kjo është shumë e vërtetë dhe këtu mund të sillen me dhjetra shembuj, por ne nuk po zgjatemi se ka elemente të tjera, sigurisht më të rëndësishme, për të evoluuar një diskutim.

Në vijim po sjellim në vëmendjen tuaj disa elemente të nevojshme për konferencën e sotme.

1. ***Marrëveshjet e tregtisë së lirë janë pa asnjë diskutim një arritje e vlerësueshme*** në rajon. Ato kanë ndryshuar dhe po ndryshojnë dita ditës klimën e komunikimit tregtar midis vendeve. Hapi i parë i madh për të liberalizuar dhe për të lehtësuar tregtinë midis vendeve të Rajonit është hedhur me këto marrëveshje. Vendi ynë është ndër më të avancuarit në këtë fushë. **Kjo është një premisë pozitive.** Më e rëndësishmja është që te ne të nxitet prodhimi për eksport, që në kushtet e tregtisë së lirë, ***ne të ndihemi edhe blerës edhe shitës.*** Deri tani subjekti është zgjidhur: Marrëveshjet ekzistojnë. Mungon objekti, s'ka prodhime suficitare në vend. Në këto rrethana, mendojmë se është po kaq dobiprurës **angazhimi po kaq i madh i strukturave shtetërore për nxitjen e prodhimeve vendase, veçanërisht atij për eksport.** Përvojat turke, polake, hungareze, bullgare, sllovene etj. janë të suksesshme sepse kanë si çelës të zgjidhjes ekonomike dhe të rritjes, prodhimin vendas. Këto përvoja tregojnë, gjithashtu, se nuk mund të ketë strategji të verteta të reduktimit të varfërisë apo të nxitjes së eksporteve pa nxitur dhe pa stimuluar prodhimin vendas. Nuk di të ketë ndonjë ligj apo ndonjë incentivë që favorizon dhe stimulon prodhimet e vendit për eksport aq sa, për shembull, u stimuluan me të drejtë, firmat e ndërtimit dhe vëllimi i ndërtimeve nga mungesa e tatimeve dhe e TVSH, për një periudhë kohe relativisht të gjatë. Zgjerimi i përmasave të tregut shqiptar, me reduktimin dhe me heqjen e tarifave doganore pas vitit 2008, përbën një avantazh të madh por vetëm potencialisht. Këmbimet e lira janë tipar i vendeve relativisht të zhvilluara, ekonomitë e të cilave këmbajnë reciprokisht lirisht ashtu siç qarkullojnë lirisht lëngjet në enët komunikuese. Në rrugën e zhvillimit perspektiv edhe vendet e Ballkanit kanë çfarë të prodhojnë, të këmbajnë dhe të komunikojnë me njeri - tjetrin. Sot është koha e nxitjes së fuqishme të iniciativave dhe investimeve në ato degë e sektorë të ekonomisë shqiptare, që kanë avantazhet e rritjes e të zhvillimit për ekonominë rajonale. Edhe brenda Komunitetit Evropian tregu i përbashkët, i zgjeronte kufijtë paralelisht me reduktimin e pengesave politike dhe me rritjen ekonomike të

vendeve antare të Tregut. Për të kaluar nga Traktati i Romës në Tregtnë pa Dogana u deshën gati 45 vjet. Në këtë këndvështrim mendojmë se është koha të përqëndrohet vëmendja tek investimet e intensifikuara në degët që na favorizojnë dimesionet e reja të tregut rajonal. Është koha t'i rikthehemi prodhimit dhe eksportit të disa prodhimeve tradicionale në fushën e bujqësisë, të industrisë agroushqimore, të artizanatit, të turizmit dhe të prodhimeve të traditës, drejt veriut të Rajonit.

2. A ka reciprocitet në tregtinë e lirë rajonale të vendit tonë? A kemi tregti të barabartë?

Kjo është një pyetje paksa e vështirë. Në njëfarë mënyre dihet se **ne mund të kemi kushte të barabarta tregtare me vendet e rajonit por kurrësi tregti të barabartë.** Ky konkluzion është trajtuar tashmë. Dëshirojmë ta vëmë theksin tek efekti që kanë marrëveshjet e tregtisë së lirë në ristrukturimin e ekonomisë shqiptare ose më saktë, në një orientim të ri strukturor. Në vendin tonë kaluam një tranzicion shumë të vështirë, gjatë të cilit u shkatërruan edhe disa kapacitete prodhuese që mund të riaftësoheshin dhe të ktheheshin në kapacitete efektive edhe për tregun e sotëm. Pak a shumë sikurse ka ndodhur në disa vende të tjera të rajonit. Në këtë këndvështrim, ekonomia jonë sot ndodhet pa punishtet e nevojshme apo fabrikat e konservimit të perimeve, të prodhimit të kompostove, të përpunimit të konservave, të peshkut, të prodhimeve blegtorale etj.. Ndëkohë, vendet e rajonit i kanë transformuar në efektive ish-kapacitetet prodhuese të 15-20 viteve më parë. Në këto kushte, ne sigurisht nuk ndihemi në pozitat e tregtisë së barabartë, por vetëm në kushte tregtare të barabarta. Pa dashur të hyjmë në objektin e ndonjë teme tjetër, fakti më domethënës i këtij konkluzioni është njëherësh rritja e vazhdueshme dhe e ndjeshme e vëllimit të importeve dhe thellimi i vazhdueshëm i deficitit tregtar. **Një nga vlerat më të mëdha të ekonomisë sonë që çmohet prej të huajve në kushtet e turizmit është gastronomia dhe, në përgjithësi, arti kulinar.** Ky element i rëndësishëm ekonomik dhe promocial i turizmit e ka bazën në dy elemente të rëndësishme: në origjinalitetin dhe në vlerat e prodhimeve bujqësore e blegtorale nga njëra anë dhe në kulturën e kuzhinës shqiptare, në të cilën gjen të pranishme edhe elemente të kuzhinës greke, edhe të asaj turke, edhe italiane njëherësh, që janë pothuaj kuzhinat më të vlerësuara dhe më të preferuara. Ky fakt, përbën në vetvete një avantazh krahasues, në rajon dhe më gjerë. Këtë avantazh krahasues ne duhet ta inkurajojmë, ta përkrahim, ta mbështesim, ta zhvillojmë. Këtë avantazh

krahasues ne duhet ta kthejmë në kapacitet prodhues e eksportues në një të ardhme të afërt. Është vendi të theksojmë se edhe sistemi bankar mund të ndikojë fuqishëm, nëpërmjet sistemit të kreditimit prioritar të investimeve bujqësore apo të industrisë agroushqimore. ***Është e nevojshme të konkludojmë se marrëveshjet e tregtisë së lirë të vëndit tonë me vendet e tjera të rajonit, duhet të shoqërohen me paketa dhe me politika inkurajuese që kanë për objektiv zhvillimin dhe përdorimin e burimeve të brendshme. Me tendencat aktuale të rritjes së shpejtë të importeve, të reduktimit ose të qëndrimit në vend të eksporteve, të thellimit përditë të bilancit të tregtisë me jashtë, të thellimit apo të vështirësisë në bilancin e veprimeve rrjedhëse me jashtë, mendojmë se në të ardhmen ekonomia jonë do të ballafaqohet me vështirësi të mëdha.***

3. Kur flasim për marrëveshje të tregtisë së lirë mbajmë gjithnjë parasysh faktin se përveç anës ekonomike, vendet palë në marrëveshje kanë edhe një kuadër tjetër; kuadrin politik, strategjik, institucional, kuadrin integruar apo përgatitje për t'u integruar në strukturat evropiane. Pa shumë komente, **marrëveshjet në aspektin politik janë iniciativë dhe veprim inkurajues.** Ato, kemi përshtypjen, vlerësohen si të tilla prej të gjithëve. **Por, marrëveshjet nuk duhet të ngelen gjithnjë dokumente kuadër, garniturë politike.** Përveç rregullimeve në fushën e tarifave doganore, aplikimi i marrëveshjeve do të kërkonte edhe rregullime të tjera në fushën e regjimeve ekonomike të vëndit tonë dhe të vendeve të tjera, të regjimeve aktive dhe të regjimeve pasive. Nëse sektorët bujqësor e blegtoral, për shembull, kanë aktualisht klimë të favorshme në fushën fiskale për brenda vëndit, në eksport ata nuk gëzojnë lehtësira. Nëse prodhimet agroindustriale eksportohen, atëherë ato përfitojnë vetëm nga lehtësirat e marrëveshjeve të tregtisë së lirë, por ndërkohë i nënshtrohen njëloj detyrimeve për të paguar TVSH, akcizat, tarifatat e shërbimeve etj.. Është fare logjike të diskutohet për shembull reduktimi i TVSH për prodhimet e eksportit agroindustrial, për prodhimet e artizanatit dhe të traditës, për prodhimet artistike etj..

Faleminderit për vëmendjen dhe interesin.

Sarandë 11 shtator 2003